



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ROZETA A. KUKA
ADRESA NR.9, HAXHI DALLIU
TEL: 682080653

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 406

Nr. koleksioni: 179

Tirane më 01/03/2023

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Notarinë", i ndryshuar



A2023052810017617695



A2023052810017617695

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
NOTERE ROZETA A. KUKA

ADRESA: Rr. "Haxhi Dalliu", Përballë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Tiranë; Taksa e pullës u pagua

KONTRATË SHITJE TË KUOTAVË
(Për transferimin e pjesëve të kuotës së kapitalit)

Sot, në Tiranë më datë 01.03.2023 (dymijë e njëzetë e tre), ditën e mërkurë, para meje, **Notere Rozeta A. Kuka**, e regjistruar në Dhomën e Noterëve Tiranë, me seli, në adresën, Rr. "Haxhi Dalliu", Hyrja 1, Tiranë, Shqipëri, u paraqitën personalisht palët e mëposhtme, të cilët kërkuan dhe ranë dakord për hartimin e kësaj Kontrate për shitblerje të kuotave (më poshtë referuar si "Kontrata"):

PALËT KONTRAKTORE:

-Z. Ermir Çupi, atësia Aqif, amësia Vera, shtetas Shqiptar, lindur në Burrel, Mat dhe banues në Tiranë, me adresë Dali Ndreu; Nd. 43; H. 9; Ap. 6; Njësia Administrative Nr. 1; Njësia Bashkiake Nr. 1; 1004; Tiranë, lindur më 09/05/1975, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035763721 dhe nr. personal H50509142K, (më poshtë referuar si "Shitësi")

Dhe

-Z. Agostin Dodaj, atësia Nikoll, amësia Marc, shtetas Shqiptar, lindur në Zejmen, Lezhë dhe banues në Kurbin, me adresë Lagja 4; Nd. 43; H. 1; Ap. 2; Laç; Laç; 4701; Kurbin, lindur më 06/08/1958, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID Nr. 033768939 dhe Nr. Personal F80806036V, (më poshtë referuar si **(Blerësi)**).

Shitësi dhe Blerësi referuar më poshtë quhen veçmas si "Pala" dhe bashkarisht si "Palët".

Baza ligjore;

Neni 761 e vijues të Kodit Civil;

Neni 73, pika 1, gërma "ç" (për kuotat e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar ose neni 117, pika 1, gërma "ç" (për aksionet e shoqërive aksionare/anonime) të Ligjit nr. 9901, datë 14.08.2009 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar;

Neni 62, gërma "ll", neni 63, pika 1, gërma "ç", si dhe nenet 99, 100, 101 e vijues të Ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

Meqënëse:

- (A) Shitësi është ortak, që zotëron 100% të kapitalit të regjistruar të Kompanisë "ENGINEERING CONSULTING GRUP" Sh.p.k, një kompani me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe funksionuar siç duhet, sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit më 8 Janar 2020, me numër unik identifikimi (NIPT) M01308013C, me seli në adresën Rruga "Arkitekt Kasemi", Pallati nr. 22, kati 1, Tiranë, Shqipëri ("Kompania");
- (B) Shitësi është i gatshëm t'i shesë Blerësit 50% e kuotës së tij (referuar më poshtë si "Kuota") në kapitalin e regjistruar të Kompanisë dhe Blerësi është i gatshëm të blejë 50% e Kuotës, sipas termave dhe kushteve të përcaktuara më poshtë.
- (C) Palët kanë rënë dakord dhe kanë vendosur me vendim të Asamblesë së ortakëve (referuar si "Vendimi i Asamblese"), Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme që 50% e kuotës së regjistruar në pronësi të Palës Shitëse të kalohen me shitje tek Blerësi.



TANI E TUTJE, Palët bien dakord përsa më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti i Kontratës

1.1 Objekti i kësaj Kontrate është transferimi nëpërmjet shitjes, nga Shitësi tek Blerësi i 50 % (pesëdhjetëpërqind) të pjesës së kuotës nga 100 %, që shitësi zotëron në kapitalin e shoqërisë "ENGINEERING CONSULTING GROUP" shpk.

1.2 Blerësi është dakort dhe merr në pronësi nëpërmjet blerjes të 50% (pesëdhjetëpërqind) të kuotave, duke u bërë ortak në shoqërisë e përcaktuar më sipër.

1.3 Pas shitjes, ortakë në shoqëri do të jenë: **Z. Ermir Çupi dhe Z. Agostin Dodaj me nga 50% secili pjesmarrje në shoqëri.**

Neni 2

Çmimi i Shitjes

2.1. Çmimi i plotë i shitjes së kuotave do të jetë në vlerën prej 250.000 (dyqindpesëdhjetëmijë) lekë të reja, i cili përfaqëson çmimin e transferimit të 50% të kuotës, të kapitalit të shoqërisë.

Neni 3

Kalimi i Pronësisë mbi kuotat

3.1 Kalimi i pronësisë mbi kuotat nga Shitësi tek Blerësi, do të bëhet në momentin e nënshkrimit të kësaj Kontrate, në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate. Blerësi do të bëhet pronar i kuotës të zotëruara dhe të mbajtura nga Shitësi në Shoqëri, duke u bërë ortak i Shoqërisë dhe pronar i 50 %, që përfaqësojnë 50 % të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.

3.2 Palët kanë detyrimin që pas nënshkrimit të kësaj kontrate të bëjnë regjistrimin e saj në QKB (Qendra Kombëtare e Biznesit).

Neni 4

Baza Ligjore

Kjo Kontratë bazohet, ndër të tjera në Nenet 761 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë i ndryshuar, në Nenet 73 e 74 të Ligjit nr. Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, në Ligjin Nr. 110 datë 20.12.2018 "Për Noterinë në Republikën e Shqipërisë", si dhe në Legjislacionin e Zbatueshëm.

Neni 5

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Në rast të çdo mosmarrëveshjeje midis Palëve në lidhje me interpretimin, kryerjen, shkeljen, ndryshimin, përfundimin apo zbatimin e kësaj Kontrate, Palët do të takohen dhe do të diskutojnë për zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje me mirëkuptim sa më shpejt të jetë e mundur.

Nëse kjo mosmarrëveshje nuk gjen zgjidhje nëpërmjet bisedimeve të drejtpërdrejta brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga kërkesa e parë për takim, atëherë Palët do t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 6

Ligji i Zbatueshëm

Kjo Kontratë është hartuar dhe do të interpretohet në përputhje me Legjislacionin e Zbatueshëm shqiptar.

Neni 7

Marrëveshja e Plotë

Kjo Kontratë së bashku me anekset e saj përbën marrëveshjen dhe mirëkuptimin e plotë ndërmjet Palëve në lidhje me objektin e saj dhe zëvendëson e ka përparësi ndaj të gjitha kontratave, marrëveshjeve ose angazhimeve të mëparshme në lidhje me objektin në fjalë.

I bashkëngjiten kësaj Kontrate Vendimi i Asamblesë së Aksionerëve, një ekstrakt nga Qendra Kombëtare e Biznesit si dhe dokumentat e identifikimit të Palëve si ("Aneksi 1").

Neni 8

Shpenzimet



A2023052810017617695

Përveç kur është shprehur specifikisht, secila Palë është përgjegjëse për çdo shpenzim ligjor apo të ndonjë lloji tjetër që ka pësuar lidhur me këtë Kontratë dhe transaksionet që rrjedhin prej saj. Palët bien dakort që shpenzimet noteriale për lidhjen e kësaj Kontrate do të merren përsipër nga ana e Blerësit.

Neni 9

Shtojcat e kontratës

Kësaj Kontrate i bashkëngjiten dhe janë pjesë përbërëse e saj:

- Ekstrakti mbi të dhënat e regjistrimit të shoqërisë "ENGINEERING CONSULTING GROUP" shpk të lëshuar nga QKB;
- Vendimi i Asamblesë së shoqërisë "ENGINEERING CONSULTING GROUP" shpk,
- Kopje të dokumentave të identifikimit të palëve.
- Rezultati i kërkimit nga Regjistri i Barrës Siguruese (RBS).

Neni 10

Kopjet e Njëjta

Kjo Kontratë përpilohet në 4 (katër) kopje të barazvlefshme. Çdo njëra prej tyre ka përmbajtje të njëjtë ligjore dhe secila Palë do të mbajë nga një kopje. Një kopje e mban Noteri. Një kopje do të depozitohet për regjistrim në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

NËNSHKRIMI

Kjo kontrate, i lexohet palëve me zë të lartë dhe të qartë, dhe pasi dëgjohet prej tyre dhe gjendet e shprehur vullneti i tyre i lirë dhe i plotë nënshkruhet rregullisht dhe unë noteria e vërtetoj në bazë të ligjit.

PALËT KONTRAKTORE

PALA SHITËSE

Z. Ermir ÇUPI

ERMIR ÇUPI

PALA BLERËSE

Z. Agostin DODAJ

NOTERE

ROZETA A. KUKA



ANEKS 1
VENDIM I ASAMBLESE SË SHOQËRISË
Shoqëria "ENGINEERING CONSULTING GROUP" shpk,
Datë: 28.02.2023

Sot më datë 28.02.2023 mbledhet Asambleja e shoqërisë "ENGINEERING CONSULTING GROUP" shpk, e regjistruar në Republikën e Shqipërisë, seli në Tiranë, e regjistruar si person juridik në datën 08.01.2020 me nr. NIPT M01308013C;

Vendimi merret nga Asambleja e Shoqërisë "ENGINEERING CONSULTING GROUP" shpk, përfaqësuar nga administratori **Z. Ermir Çupi**, i datëlindjes 09.05.1975 lindur në Mat dhe banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike, mbajtës i dokumentit të identifikimit letërnjoftim ID Nr.035763721, Nr. Personal H50509142K i vlefshëm deri më datë 05.02.2030.

Pjesëmarrja në mbledhje :

Z. Ermir Çupi, zotërues i kuotës 100%, që përfaqëson, 100% të kapitalit të Shoqërisë.

Axhenda e takimit është:

1. Transferimin nëpërmjet shitjes nga Shitësi **Z. Ermir Çupi** në favor të **Z. Agostin Dodaj**, të 50% të kapitalit të shoqërisë, me çmimin 250.000 (dyqindpesëdhjetëmijë) të reja.
2. Blerjen e 50% të kapitalit të shoqërisë nga ana e **Z. Agostin Dodaj**, me çmimin 250.000 (dyqindpesëdhjetëmijë) lekë të reja.
3. Reflektimin e ndryshimeve të mësipërme, duke përcaktuar qartë ortakët e shoqërisë "ENGINEERING CONSULTING GROUP" shpk, me pjesmarrjen e tyre dhe konkretisht; **Z. Ermir Çupi** me 50% të pjesës në kapital dhe **Z. Agostin Dodaj** me 50% të pjesës në kapital.
4. Autorizimin për regjistrimin e kontratës së shitblerjes së kuotave të shoqërisë "ENGINEERING CONSULTING GROUP" shpk dhe të vendimit të Asamblesë së datës 28.02.2023 në QKB (Qendër Kombëtare të Biznesit) të Znj. OLLGA MITROKOSTA.

Asambleja e Shoqërisë "ENGINEERING CONSULTING GROUP" shpk;

V E N D O S I:

5. Transferimin nëpërmjet shitjes nga Shitësi **Z. Ermir Çupi** në favor të **Z. Agostin Dodaj**, të 50% të kapitalit të shoqërisë, me çmimin 250.000 (dyqindpesëdhjetëmijë) të reja.
6. Blerjen e 50% të kapitalit të shoqërisë nga ana e **Z. Agostin Dodaj**, me çmimin 250.000 (dyqindpesëdhjetëmijë) lekë të reja.
7. Reflektimin e ndryshimeve të mësipërme, duke përcaktuar qartë ortakët e shoqërisë "ENGINEERING CONSULTING GROUP" shpk, me pjesmarrjen e tyre dhe konkretisht; **Z. Ermir Çupi** me 50% të pjesës në kapital dhe **Z. Agostin Dodaj** me 50% të pjesës në kapital.
8. Autorizimin për regjistrimin e kontratës së shitblerjes së kuotave të shoqërisë "ENGINEERING CONSULTING GROUP" shpk dhe të vendimit të Asamblesë së datës 28.02.2023 në QKB (Qendër Kombëtare të Biznesit) të Znj. OLLGA MITROKOSTA.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË "ENGINEERING CONSULTING GROUP" shpk

Z. Ermir ÇUPI





REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit të Kërkimit: D-2023030281044518
Data e Rezultatit të Kërkimit: 02.03.2023
Ora e Rezultatit të Kërkimit: 8:10:44AM
Lloji i Kërkimit:
Numri i Dokumentit: D-400-659-191
Referenca e Përdoruesit:

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KËRKIMI 0

ENGINEERING CONSULTING GROUP SH.P.K.



Orëgjithori